



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

NR.3304/539/1308 AKTI

NR.739VENDIMI

Datë 20.12.2021/17.03.2022

Datë 17.03.2022

V E N D I M

" NE EMER TE REPUBLIKES "

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë e përbërë prej :

GJYQTARE: SHEFKIE DEMIRAJ(MATAJ)

Asistuar nga sekretare gjyqesore **Pandora Gjini**, me pjesëmarrjen e prokurorit **Arian Permeti**, sot me date **17.03.2022** , shqyrtoi në séancë gjyqësore publike çështjen penale në ngarkim të të:

- **P A N D E H U R I T**:Eduart Sulioti, i biri Andreas dhe Lauretes , i datelindjes 02.02.1993 , lindur në Elbasan dhe e banues rruga “Muhamet Deliu”, rruga e thesarit prane lavazh “Elios” pallat pa nr Tirane, me arsim i mesem , gjendje gjyqesore i padenuar, me gjendje civile beqar , me shtetesi dhe kombesi shqiptare cel. 067 71 11 111 ID J30202083 Q, mbrojtur ne gjykim nga Av.Martin Hicka identifikuar me nr license 9436 nipti L91811036J nr tel 0694113746 dhe av. Ilir Murra me nr license 3467 dhe nr nipti K82915204H, nr cel 0692661036 (zgjedhur me deklarim)
-
-
- **AKUZUAR:** Për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e lendeve narkotikeve”
-
- **PARASHIKUAR:** Nga neni 283/1 i Kodit Penal.
-
- Gjykata administroi provat, degjoi palet qe perfundimisht kerkuan:
-
- -Prokuror Arian Permeti:Deklarimin fajtor të pandehurit Eduart Sulioti, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e lendeve narkotikëve” dhe në bazë të nenit 283/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim
-
- Në dhënien e masës së dënimit Gjykata të ketë parasysh aplikimin e nenit 406/ 1 të K.Pr.Penale, mbi gjykim e shkurtuar për të pandehurin Eduart Sulioti, duke i ulur 1/3 e masës së dënimit, duke e dënuar me 3 (tre) vjet e 4(kater) muaj burgim.
- Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe rrethanave të kryerjes së veprës penale, i kërkojmë Gjykatës të urdhërojë që i dënuari të vihet në kohë prove prej 3 vitesh duke u pezulluar ekzekutimi i vendimit

me burgim, me kusht që gjatë kohës së provës i dënuari - të mos kryej vepër tjetër penale si dhe të mbaj kontakte me ZVSH P Tirane.

- Detyrimin e të pandehurit për të paguar shpenzimet proceduriale gjatë hetimeve paraprake dhe ato gjatë shqyrtimit gjyqësor që do të caktohen nga ana e gjykates.
- -Av.Illir Murra kerkoi: Aplikimin e nenit 59 te K Penal.
- I pandehuri Eduart Sulioti kerkoi: meshire
- Gjykata pasi, e bisedoi çeshtjen ne teresi:
- V E R E N
-
- Se nga organi i Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Tiranë ka ardhur ne Gjykate per gjykim procedimi penal nr. 5230 i vitit 2021 ne ngarkim te te pandehurit Eduart Sulioti akuzuar per vepren penale "Prodhimi dhe shitja e lendeve narkotike" parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal.
-
- Gjykata pasi studioi materialet e çeshtjes penale ardhur per gjykim bazuar ne nenin 69 te K.Pr.Penale, çmoi se çeshtja eshte ne juridiksionin e saj dhe gjykimi i kesaj çeshtje penale duhet te realizohet perpara kesaj gjykate.
- Kjo çeshtje ne baze te neneve 13 dhe 74 te K.Pr.Penale, eshte ne kompetencen lendore te kesaj gjykate, pasi veprat penale per te cilat është proceduar i pandehuri gjykohet me trup gjykues te perbere nga nje gjyqtar.
- Persa i perket kompetences tokesore, ajo percaktohet shprehimisht ne nenin 76 te K.Pr.Penale ku citohet se: "Kompetenca tokesore percaktohet, me rradhe, nga vendi ku eshte kryer ose tentohet te kryhet vepra penale ose vendi ku ka ardhur pasoja". Persa me siper, perderisa vepra penale dyshohet se eshte kryer ne Tiranë, kompetente eshte Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.
- Gjithashtu, Gjykata ne veshtrim te neneve 13,15,16,17,18 te K.Pr.Penale, çmoi se nuk ekzistojne shkaqe papajtuesmerie ose perjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pakundershtuar edhe nga palet, pas prezantimit te trupit gjykues.
- Ne perfundim te shqyrtimit gjyqësor me procedure te gjykimit te shkurtuar ka rezultuar e provuar se: Nga ana e Seksionit për Hetimin te Narkotikëve të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë janë siguruar informacione në rrugë operative se i pandehuri Eduart Sulioti , mban lendë narkotike, llojit "Kokaine", ne zonen e "Freskut" duke perdorur automjetin tip BENZ me targe AA 729 CZ.
- Ne date 19.07.2021 rrethores 20:10 min, ne rruget "Muhamet Deliu" eshte konstatuar i pandehuri Eduart Sulioti, i cili sapo ka parë punonjësit e policisë, është larguar me vrap. Gjatë kohës që po largohej, ka nxjerrë nga çanta e tij e krahut, disa sende në dukje si qese dhe i ka futur në gojë.
- Pas ndalimit të pandehurit Eduart Sulioti, ky i fundit ka nxjerrë nga goja katër qese plastike të spërdredhura, të djegura në majën e tyre, ku brënda tyre ndodhej një pluhur i bardhë, i ngjashëm me lëndën narkotike të llojit "Kokainë". Për dokumentimin e këtij fakti u bë peshimi i lëndës së dyshuar narkotike.
- Peshimi u krye me peshore elektronike të markës Adam.
- Pasi u bë sekuestrimi i lëndës dyshuar narkotike të llojit Kokaine, gjendur me vete shtetasit Eduart Sulioti, u bë peshimi i saj dhe rezultoi me peshë të përgjithshme me amballazh 16.6 (gjashtëmbëdhjet pik gjashtë) gram, e cila pas peshimit u fut në qesen e provave me Nr.UNIK. B20000230.
- Nga ana e of.pol.gjyq u përpiluan vendimet përkatëse të ekspertimit kimik dhe toksikologjik.

- Është administruar akti ekspertimit toksikologjik, nr. 1896 datë 02.08.2021, i kryer nga ekspertë të I.M.L-së Tiranë, në përfundim të të cilit eksperti ka konkluduar : Në mosttrën e urinës, marrë shtetasit Eduart Sulioti, mbyllur në kontenier dhe futur në qesen e provave unik Nr.B20000285, u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të Kokainës në organizmin e njeriut".
- Është administruar akti ekspertimit kimik të lëndës nr. 10235 vitit 2021, i kryer nga ekspertë të I.P.SH-së, në përfundim të të cilit ekspertët kanë konkluduar: 1- Analiza me GC/MS për materialet objekt ekspertimi treguan praninë e kokainës. 2- pesha e materialeve pa ambalazh është 15.805 gram"
-
- Ne rrethanat e lartpërmendura Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane ka filluar procedimin penal ndaj te pandehurit Eduart Sulioti, duke e akuzuar ate per vepren penale "Prodhimi dhe shitja e lendeve narkotike" parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.
- Hetimi dhe gjykimi i çështjes ndaj te pandehurit Eduart Sulioti eshte bere fillimisht me me masen e sigurimit personal me karakter shtrengues "arrest ne burg" nga data 19.07.2021 -17.11.2022 dhe nga kjo date e ne vijim masen e sigurimit personal "arrest ne shtepi"
- Para se te filloje shqyrtimi gjyqësor i çështjes i pandehuri Eduart Sulioti nepermjet mbrojtësit te zgjedhur prej tij ne séancen gjyqësore te hetimit paraprak kerkoj qe te proçedohet me gjykim te posacem ate te shkurtuar ne gjendjen qe jane aktet e prokurorit .
- Me Ligjin Nr. 41/2021 "Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Ligjin Nr. 7905, Datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", janë bërë ndryshime lidhur me disponimet e gjyqtarit të seancës paraprake. Kështu, me ndryshimet që janë bërë neni 332 i K.Pr.Penale Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se nëse paraqitet nga i pandehuri kërkesë për të proceduar me gjykim të posacem ate te shkurtuar dhe plotësohen kushtet ligjore për pranimin e saj, gjyqtari i seancës paraprake nuk merr vendim për dërgimin e çështjes për gjykim por gjyqtari i seancës paraprake shndërohet në gjyqtar themeli dhe ushtron të gjitha kompetencat e tij.
- Përsa më sipër referuar faktit se i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, gjatë seancës paraprake, shfaqën vullnetin për tu proçeduar me gjykim të shkurtuar, gjykata bazuar në nënin 332/c e Kodit të Proçedurës Penale vijon gjykimin e kësaj çështje duke marë tagrat e gjykatës së themelit.
- Gjykata pasi mori mendimin pozitiv te prokurorit, e gjeti kerkesen e te pandeuhurit te mbeshtetur ne ligj, neni 405/6 i K.Pr.Penale, proçedoi me gjykim te posacem ate te shkurtuar, pasi çmoi se çështja mund te zgjidhej ne gjendjen qe jane aktet e prokurorit. Kunder ketij vendimi lejohet ankim se bashku me vendimin perfundimtar.
-
- Gjykata krijoi bindjen e bazuar ne prova se i pandehuri Eduart Sulioti ka kryer vepren penale te parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal e per rrjedhoje duhet te pergjigjet penalisht.
- Lidhur sa sipër Gjykata vëren se neni 283/1 i K.Penal parashikon se:
-
- « Shitja, ofrimi per shitje, dhënia ose marrja ne cdo forme, shperndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorezimi, si dhe mbajtja, pervec rastit te perdorimit vetjak dhe

ne doza te vogla te substancave narkotike dhe psikotrope si edhe i farerave te bimeve narkotike, ne kundërshtim me ligjin ose kapërcim te permbajtjes se tyre, denohet me burgim nga pese gjer ne dhjete vjet».

- Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme rezulton se ligjvënësi ka parashikuar mbrojtje të posaçme juridike të marrëdhënieve te vendosura ne baze te ligjit “Per narkotiket” per te siguruar rendin dhe sigurine publike, jeten dhe shendetin e personit, te mbrojtura posaçerisht me legjislacionin penal nga veprimet kriminale.
- Veprimet që çënojnë marrëdhëniet e sipërpërmendura passjellin përgjegjësi penale. Këto veprime, për t’u cilësuar si vepër penale nga ligji, duhet që :
- Subjekti : I pandehuri Eduart Sulioti ka mbushur moshen per përgjegjesi penale, eshte i përgjegjshem para ligjit dhe nuk ka shkaqe padenueshmerie.
- Ana subjektive : I pandehuri Eduart Sulioti vepren penale e ka kryer me dashje te drejperdrejte.
- Objekti Jane cenuar nga i pandehuri Eduart Sulioti marrëdhëniet juridike te vendosura nga shteti per te siguruar rendin dhe sigurine publike, jeten dhe shendetin e personit, te mbrojtura posaçerisht me legjislacionin penal nga veprimet kriminale.
- Ana objektive :Vepra penale e parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal eshte kryer nga i pandehuri Eduart Sulioti me veprime aktive shoqerisht te rrezikshme e te kundraligjshme ne formen e mbajtjes se lendes narkotike.
- Sa siper u provua me provat e administruara gjate shqyrtimit gjyqesor te çeshtjes si:
- Proces-verbali i kapjes ne flagrance date 19.07.2021
- Raporti sherbimi i mbajtur nga punonjesit e policise date 19.07.2021
- Proces-verba i kqyrje-marje proves materiale date 19.07.2021.
- Proces-verbal i peshimit te proves materiale .
- proces-verbal per sekuestrimin e proves materiale
- Aktet e ekspertimit kimik te lendes nr.10235/2021
- Proces-verbal i marrjes se kampionit te urines .
- Akti ekspertimi toksikologjik nr.1896/2021, ku eshte konkluduar : Në mosttrën e urinës, marrë shtetasit Eduart Sulioti, mbyllur në kontenier dhe futur në qesen e provave unik Nr.B20000285, u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të Kokainës në organizmin e njeriut".
- Akti ekspertimit toksikologjik nr. 10235 vitit 2021, i kryer nga ekspertë të I.P.SH-së, ku është konkluduar: 1- Analiza me GC/MS për materialet objekt ekspertimi treguan praninë e kokainës. 2- pesha e materialeve pa amballazh është 15.805 gram"
- Proces-verbal i arrestimit ne flagrance,
- Si dhe në tërësi aktet e fashikullit të procedimit penal Nr.5230 te vitit 2021.
- Gjykata procedoi me procedure te gjykimit te shkurtuar mbi kerkesen e te pandehurit, c’ka do te thote se gjykimi i ceshtjes u be me provat e sjella nga prokurori i ceshtjes, te cilat kishin vlere provuese per gjykaten ne lidhje me fajesine e te pandehurit per vepren penale te parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal.
-
- Gjykata bazuar ne nenin 152/1 te K.Pr.Penale ku parashtrohet se “...çdo prove i nenshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlere te paracaktuar. Gjykata i cmon provat sipas bindjes se formuar pas shqyrtimit te tyre ne teresi” pare ne kete kendveshtrim u shqyrtuan me vemendje provat e marra konform Ligjit Procedural Penal.

- Këto prova të marra në tërësi e bindin plotësisht gjykatën për egzistencën e faktit dhe fajësinë e të pandehurit Rezi Karalli , i cili duhet te deklarohet fajtor per vepren penale te parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal.
- Në caktimin e masës së dënimit gjykata merr ne konsiderate faktin se denimi ka karakter individual dhe ne kete kuptim, ne dhenien e tij duhet te mbahen parasysh rrezikshmeria e vepres penale, e autorit te saj, shkallen e fajesise, rrethanat lehtesuese dhe renduese me qellim qe ai te jete ne pershtatshmeri dhe raport te drejte, jo vetem me rrezikshmerine e vepres dhe te autorit te saj, por dhe qe te jete i tille qe te vlej per rehabilitimin e tij. Ne masen e dënimit Gjykata ka parasysh rrezikshmerine shoqerore te vepres penale. Gjithashtu ka parasysh qendrimin pendues te te pandehurit ndaj vepres penale (neni 48/ç) i Kodit Penal, personalitetin e te pandehurit si person i padenuar me pare . Gjithashtu gjykata ka parasysh faktin se i pandehuri eshte perdorues i lendes narkotike si dhe sasine e vogel te lendes sekuestruar te pandehurit.
- Nisur sa sipër Gjykata cmon se i pandehuri Eduart Sulioti duhet të dënohet me 5 (pese) vjet burgim .Ne kushtet e procedimit me gjykim te shkurtuar gjykata bazuar ne nenin 406/1 të K.Pr.Penale e denon te pandehurin me 3 (tre) vjet e 4(kater) muaj burgim.
- Gjykata cmon se per te pandehurin Eduart Sulioti ndodhemi ne kushtet e nenit 59 te K.Penal , kerkese e bere nga prokurori i ceshtjes Arian Permeti .
- Neni 59 i KPenal, sanksionon:
- “Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës apo nevojave, vecanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale si dhe sjelljes pas kryerjes së veprës penale gjykata kur jep dënimin me burg deri në pesë vjet mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë duke pezulluar ekzekutimin e dënimit me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.
- I pandehuri Eduart Sulioti paraqet rrezikshmeri te paket shoqerore, pasi eshte person i padenuar me pare per asnje lloj vepre penale.
- Gjykata merr ne konsiderate faktin se i pandehuri ka mbajtur qendrim pendues ndaj vepres penale te kryer nga ana e tij gjate shqyrtimit gjyqesor (neni 48/ç i K.Penal).
- Gjykata ne aplikimin e nenit 59 te K Penal ka ne qender te vemendjes faktin se i pandehuri eshte perdorues i lendes narkotike (provuar ky fakt me akt ekspertimi toksikologjik nr. 1896/2021
- Gjithashtu gjykata mban parasysh gjendjen shendetesore te te pandehurit (provuar ky fakt me akte mjekesore administruar ne dosje)
- Gjykata ne aplikimin e nenit 59 te K Penal ka ne qender te vemendjes faktin se i pandehuri gezon respekt ne komunitetin ku jeton (provuar ky fakt me karakteristike nr 47 prot date 08.02.2022)
- Gjykata cmon se ky dënim është plotësisht i justifikueshëm, ne raport me rrezikshmërinë shoqerore të vepres penale rrethanave të kryerjes së saj si dhe rrezikshmërinë e të pandehurit në rastin konkret duke aplikuar nenin 59 te K Penal. Gjithashtu Gjykata çmon se ky dënim do t'i shërbejë edukimit të të pandehurit, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga ai, rehabilitimit të tij, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri.
- Gjykata duhet te shprehet dhe per proven materiale te sekuestruar (neni 190 i K.Pr.Penale).

- Duke qenë se i pandehuri Eduart Sulioti u deklarua fajtor gjatë këtij gjykimi për vepren penale për të cilën u akuzua, bazuar në nenin 485 të K.Pr.Penale, i pandehuri detyrohet të paguajë shpenzimet proceduriale të parapaguara nga shteti, si gjatë fazës së hetimeve paraprake ashtu dhe shpenzimet gjyqësore.
-
- Gjykata pasi beri harmonizimin e të gjitha provave njera me tjetren krijoi bindjen e plote se i pandehuri Eduart Sulioti është autor i vepres penale “Prodhimi dhe shitja e lendeve narkotike” parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal e për rrjedhojë duhet të pergjigjet sipas sanksioneve ligjore perkatese.
- **PER KETO ARSYE**
- Gjykata bazuar në nenet 379/1, 382, 383, 384, 390 të K.Pr.Penale, 283/1, 47, 48/ç, 49, 59, 61,60/9 të K.Penal, 403, 405/6, 406/1, 190, 485 të K.Pr.Penale
- **V E N D O S I**
- Deklarimin fajtor të pandehurit Eduart Sulioti për vepren penale “Prodhimi dhe shitja e lendeve narkotike”, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal dhe denimin e tij me 5 (pese) vjet burgim.
- Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale i ulet 1/3 e denimit duke e denuar të pandehurin Eduart Sulioti me 3 (tre) vjet e 4(kater) muaj burgim.
- Në aplikim të nenit 59 (të ndryshuar) të K.Penal urdherohet pezullimi i ekzekutimit të denimit të mbetur me burgim për të pandehurin Eduart Sulioti duke e vene në prove për një afat kohor prej 3 (tre) vitesh, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë vepra tjeter penale.
- Urdherohet i pandehuri Eduart Sulioti të mbaje kontakte me Zyren Vendore të Sherbimit të Proves Tirane, duke e vene ate në dijeni për ndryshimin e banesës (neni 61 i K Penal).
- Urdherohet i pandehuri Eduart Sulioti të mos shoqerohet me persona të caktuar kryesisht të denuar (neni 60/9 i K.Penal).
- Bazuar në nenin 389 të K Pr Penal heqjen e masës së sigurimi “arrest në shtëpi” caktuar me vendimin nr 1239/2 regj date 17.11.2021
- Bazuar në nenin 190 pika 1 gërma “b” të K.Pr.Penal, prova materiale e sekuestruar me procesverbalin datë 19.07.2021 lenda narkotike e llojit “kokaine”, me peshe gjithsej 16.6 (gjashtembedhete pike gjashte) gram me gjithë ambalazh, të asgjeshet.
- Telefoni i markes Iphone 11 pro me ngjyre gold të kthehet të pandehurit Eduart Sulioti
- Shpenzimet proceduriale të parapaguara nga shteti në fazën e hetimeve paraprake dhe ato gjyqësore i ngarkohen të pandehurit Eduart Sulioti
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi nga palet në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmeja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall sot në Tiranë date, 17.03.2022

SEKRETARE

GJYQTARE

PANDORA GJINI

SHEFKIE DEMIRAJ (MATAJ)

Shpenzime hetimore

16.000 (gjashtembedhete mije) leke

Shpenzime gjyqësore

Njoftime 2 copë x 150 = 300 (treqind) **Lekë**